



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202301190/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të pacientëve të Shërbimit të Psikiatrisë QSU "Nënë Tereza" Tiranë*

Drejtuar : **Prof. Asc. Albana FICO**
Drejtoreshë e Përgjithshme e QSU "Nënë Tereza"

Prof. Ariel ÇOMO
Shefi i Shërbimit të Psikiatrisë QSU "Nënë Tereza"

Për Dijeni : **Znj. Ogerta MANASTIRLIU**
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Të nderuar drejtues,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Spitalin Psikiatrik "Xhavit Gjata" Tiranë, më datë 12.12.2023, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2023 të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Lindita Dedëgjoni, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu nd/komisionere të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Inspektimi pati për objekt mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e pacientëve, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin ligjor t'ju parashtrijë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza” Tiranë për vitin 2023. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues zhvilloi takim paraprak dhe mori një informacion të përgjithshëm nga Dr. Ariel Çomo Shef i Shërbimit Psikiatrik, Dr. Fatime Elezi Përgjegjëse e Urgjencave Psikiatrike, z. Tedi Mana psikolog, Ornela Jahaj, administratore e Polit të Administrimit të Integruar (PAI) Neuroshkencës, Klodian Luci përgjegjës i sektorit të marrëdhënieve ligjore në Drejtorinë Spitalore QSUT.

Më tej, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij spitali. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve në këtë spital, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës.

Grupi i inspektimit u shoqërua nga stafi i shërbimit në vizitën e zhvilluar në ambientet spitalore të trajtimit të pacientëve me probleme të shëndetit mendor: shërbimi për fëmijë, shërbimi për të rritur meshkuj, shërbimi për të rritur femra, seksioni i adiktologjisë dhe urgjenca psikiatrike.

Shërbimi Psikiatrik në ditën e inspektimit zhvillohej përkatësisht në disa pavijone sipas kategorive përkatësisht:

Kapaciteti i Spitalit Psikiatrik Universitar “Xhavit Gjata” sëbashku me klinikën e psikiatrisë së fëmijëve dhe adoleshentëve dhe urgjencën është për 90 pacientë.

Në ditën e inspektimit në shërbim kishte 68 pacientë përkatësisht:

I. Urgjenca Psikiatrike

Njësia e pranimit të urgjencave me kapacitet 6 shtretër - 3 urgjenca të zëna;

Pavijoni I. Urgjenca psikiatrike (burra) 14 shtretër – 10 pacientë;

Pavijoni II. Urgjenca psikiatrike (gra) 14 shtretër – 11 pacientë.

II. Psikiatria E Përgjithshme

Pavijoni I. Psikiatria e përgjithshme (burra) 24 shtretër – 21 pacientë;

Pavijoni II. Psikiatria e përgjithshme (gra) 24 shtretër – 22 pacientë.

III. Klinika Psikiatrike Fëmijë Dhe Adoleshentë 8 shtretër – 1 pacient (gjinia meshkuj, 17 vjeç).

Ndarja me numra Gra/ Burra, 33 burra + 1 infantili, 34 gra.

Organika e institucionit përbëhej nga:

Shërbimi i Psikiatrisë:

Shef Shërbimi (Mjek) – 1

Përgjegjës Urgjence Psikiatrike (Mjek) – 1

Psikolog Klinik – 3

Infermier Pavijoni – 26

Shoqërues Force- 6

Njësia e Psikiatrisë së Përgjithshme:

Mjek -2

Kryeinfermier – 2

Specialist Workshopi- 1

Specialist mësues Fiskulturë – 1

Kujdestar – 5

Infermier Taks Force/ Kujdestar -3

Njësia e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoloshentëve:

Mjek- 5

Psikolog Psikometrist -1

Kryeinfermier -1

Njësia e Urgjencës Psikiatrike:

Mjek – 5

Kryeinfermier Urgjence – 4

Infermier Urgjence – 25

Infermier Taks- Force/Kujdestar- 4.

Sipas strukturës organike të miratuar nga Drejtoria e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza, në mungesë është një infermier në Njësinë e Urgjencës Psikiatrike. Në bashkëbisedimin me shefin e shërbimit të psikiatrisë, grupi inspektues kërkoi një informacion të përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i një viti më parë¹ si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprore.

Në vijim Institucioni i Avokatit të Popullit në mungesë të përgjigjeve mbi rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit për vitin 2022 me shkresën nr. K4/I88-2 Prot, datë 21.12.2022, ka tërhequr vëmendjen e institucionit që ju drejtoni me rekomandimin K4/I88-3 Prot. Datë 27.09.2023, “ *Rekomandim për marrjen e masave disiplinore për refuzimin e bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit*” drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Lidhur me këtë është e nevojshme që në vazhdimësi të ketë një koordinim brenda strukturave nga të cilat drejtohet shërbimi i psikiatrisë dhe të ketë një angazhim lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe kthimin e përgjigjeve në kohë sipas legjislacionit në fuqi.

Nga informacioni i marrë në ditën e inspektimit dhe këqyrja e ambienteve rezultoi se vetëm një pjesë e rekomandimeve të lënë nga inspektimi i mëparshëm kishin gjetur zbatim dhe konkretisht:

Nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet për:

- Marrjen e masave të menjëhershme për të përmirësuar situatën e përgjithshme infrastrukurore në pavijone si një nevojë imediate që lidhet me rekomandimet ndër vite të Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe standardet e kërkuara dhe parashtruara nga CPT-ja dhe KE, për një trajtim sa me cilësor dhe human të personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor.
- Marrjen e masave për vënien në funksion të plotë të sistemit qendror të ngrohjes.
- Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e regjistrave të sekretuar nga ana e drejtorisë juridike pranë QSUT-së, si dhe marrjen e masave administrative për punonjësit që nuk kanë siguruar, pavarësisht rekomandimit, sekretimin e regjistrave.
- Marrjen e masave urgjente për krijimin e një pavijoni të posaçëm për persona abuzues me substanca narkotike, të cilët manifestojnë çrregullime të sjelljes apo/dhe psikotike, të cilët janë në rritje në numër dhe për shkak të karakteristikave të tyre, kërkojnë një trajtim me të orientuar bio-psiko-social.

¹ *Rekomandim i Avokatit të Popullit K4/I88-2 Prot, Dt. 21.12.2022.*

Hera herës ky target grup pacientësh ka sjelle problematika në menaxhim, çka sjell si nevojë dhe trajnim stafi për këtë target grup.

- Marrjen e masave për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive Psiko-sociale nëpërmjet investimit për të krijuar ambiente të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese nga ana e stafit psiko-social.
- Vënien në funksion të dhomës së izolimit duke e rindërtuar dhe pajisur në përputhje me standardet.

Konteksti dhe kuadri ligjor e institucional

Shërbimi shëndetësor në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri është rregulluar me ligj të posaçëm që në vitin 1996, përkatësisht me ligjin nr. 8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”, i cili më pas u shfuqizua me ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, që synonte përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e kësaj kategorie. Ky ligj solli nevojën e reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare të shëndetit mendor për të gjithë (përfshi dhe institucionalizimin të personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj).

Në konceptin gjithëpërfshirës, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal. Pavarësisht sa më sipër, nevojat në rritje për këto shërbimeve, nuk kanë sjellë shtimin e kapaciteteve, për të adresuar nevojat e popullatës veçanërisht në lidhje me trajtimin e pacientëve me probleme të shëndetit mendor.

Kushtet materiale dhe trajtimi i pacientëve.

Pavijoni i Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshentë është me kushte dhe standarde bashkëkohore për trajtimin e fëmijëve që vuajnë nga problemet e shëndetit mendor. Klinika e Psikiatrisë së Fëmijëve e Adoleshentëve është një njësi e posaçme brenda shërbimit të Psikiatrisë, është e vetmja strukturë me shtretër për këtë profil në vend, si ofruesja e shërbimeve terciare në psikiatrinë e moshave nën 18 vjeç me një kapacitet prej 8 shtretër.

Gjate vizitës monitoruese u mor kontakt me miratimin e prindërve dhe praninë e psikologut, me një pacient të shtruar në pavijonin e psikiatrisë për fëmijë, 14 vjeç i

cili kishte pak ditë i shtruar në këtë pavijon. Pacienti paraqitej në kushte të mira në dhomën e shtrimit duke marrë kujdesin e nevojshëm nga stafi mjekësor.

Gjate vitit 2023 janë kryer tre procedura ligjore për trajtim të pavullnetshëm. Të gjitha këto procedura janë të paraqitura në regjistrin e trajtimit të pavullnetshëm sipas afateve ligjore, konform nenit 20 të ligjit nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Kjo klinikë ofron shërbime ambulatorë, shërbime të Spitalit Ditor dhe shtrimet tipike afatshkurtra e afatmesme për rreth 1500 fëmijë e adoleshentë në vit. Çrregullimet e zhvillimit, psikozat e hershme, çrregullimet afektive, çrregullimet e ankthit, anoreksitë dhe çrregullimet e tjera të ushqyerjes përbëjnë diagnozat më të shpeshta të trajtuara.

Nga Avokati i Popullit u konstatua që nga kërkesa e mjekut psikiatër për revokim të Trajtimit të pavullnetshëm deri nga dalja e pacientit nga spitali ishte një periudhë kohore mbi një javë, kjo për shkak se Vendimi i gjykatës për rënien/revokimin e Trajtimit të pavullnetshëm vononte shume deri në ardhjen në shërbimin e psikiatrisë, duke rritur në këtë mënyrë ditët e qëndrimit të pacientit dhe mbasi kanë rënë shkaqet që personi të mbahet për trajtim të pavullnetshëm. Kjo tregon një hendek koordinimi Institucional (QSUT– Spitali Psikiatrik) dhe Ndërinstitucional (Gjykata – QSUT).

Shërbimi psikiatrik për të rritur vazhdon të vuajë nga mungesa që lidhen me përmirësimin e kushteve materiale, në amortizimin e tejskajshëm të ambienteve të përbashkëta të higjienës, mungesës së sistemit të ngrohjes e ftohjes në pavijone dhe nevojës për ambiente të përshtatshme rehabilitimi.

Përgjatë inspektimit sipas, Administratores të Polit të Administrimit të Integruar (PAI) Neuroshkencës znj. Ornela Jahaj, prezente gjatë inspektimit, përgjatë vitit 2023 na informoi se janë bërë investime të ndryshme si, lysterje te pjesshme ne te gjitha pavijonet dhe lysterje totale në shtator 2023, si dhe meremetime, mirëmbajtje (ndërrime grupe dushi, hidraulike, etj.) për çdo problematikë qe bëhet prezente çdo dite duke pare situatat ne pavijone.

Për më shumë se tre vite është bërë plani i rikonstruktimit, por situata vazhdon të jetë akoma më e rënduar në Pavijonin e Urgjencës si dhe në Ambientet Rehabilituese, kjo e cituar dhe në tre raportet e mëparshme te Avokatit të Popullit. Edhe në momentin e kryerjes së këtij inspektimi nuk ka filluar ende rikonstruksioni i këtij institucioni dhe kjo është bërë shkak i paraqitjes edhe më të rënduar të kushteve të të gjithë ambienteve.

Avokati i Popullit vlerëson se është emergjencë për t’i dhënë një vëmendje të shtuar kësaj problematike disa vjeçare, nisur kjo nga kushtet aktuale që gjendet ky institucion

si dhe në ofrimin e një shërbimi mjekësor sa më cilësor dhe human për të ofruar një trajtim sa më njerëzor, në mënyrë që të realizohet akreditimi i këtij spitali sipas standardeve dhe kërkesave të Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve të Shëndetësisë, si dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues, të cilat i janë drejtuar edhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale².

Ashtu siç është konstatuar dhe në raportet e mëparshme dhe është paraqitur dhe në rekomandimin e vitit 2022, grupi i inspektimit konstatoi se ambientet e brendshme të katit të parë dhe të tretë janë në gjendje të rënduar, riparimet apo lyerja e pjesshme janë të pamjaftueshme. Gjatë inspektimit u konstatua që tavanet në korridore në çdo kat të spitalit kanë lagështi të theksuar duke krijuar kushte të rënduara për shëndetin e pacientëve. Në dhomat e pacientëve ose mungojnë dollapët dhe komodinat personale të pacienteve ose janë shumë të amortizuara. Dhoma e izolimit vazhdon të jetë jashtë funksionit, pasi nuk është ndërtuar dhe pajisur në përputhje me standardet. Tualetet kanë një nivel shumë të lartë amortizimi, pllakat janë të rrëshqitshme e në këtë mënyrë nuk ofrohet asnjë lloj standardi sipas nevojave dhe specifikave të pacientëve me probleme të shëndetit mendor apo me nevoja te veçanta .Këto gjetje tregojnë se Spitali Psikiatrik ka nevojë **URGJENTE** për rikonstrukcion të plotë.

Gjithashtu ambientet e jashtme dhe kopshti përballë spitalit vazhdojnë të jenë jo funksionale për pacientët. Ky ambient ka mungesë stolash, në funksion të shërbimit të ajrimit të pacientëve që mundet të dalin si p.sh. më shume stola me strehëza për diell.

Këto problematika të përsëritura kthehen në **kushte të papërshtatshme** për pacientët dhe për stafin mjekësor dhe stafin mbështetës, të cilët duhet të përballojnë çdo ditë dinamika komplekse të sëmurëve kronike dhe akutë.

Procedura e ndjekur për shtrimet e pavullnetshme në këtë shërbim dhe informimi i pacientëve dhe personave të tjerë të interesuar, dokumentohej në kartelën mjekësore të pacientit bazuar në nenin 24 pika 6 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, të ndryshuar. Nga ana e grupit të inspektimit u evidentua që regjistrat ndonëse janë të plotësuar, vazhdojnë të jene te pa sekretuara, duke mos marre në këtë mënyrë attribute ligjore.

Nga ana e shërbimit u informuam që janë përdorur mjetet e kufizimit fizik (këmisha force), por numri i tyre mbetet mjaft i kufizuar e gjendja e tyre shumë e vjetëruar. Nevoja për mbështetje më të mëdha financiare mbetet prezent për të gjitha institucionet me shtretër në rang kombëtar.

² <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20CPT.pdf> *Seksioni Iii Ministria E Shëndetësisë Dhe Mbrojtjes Sociale.*

Lidhur me trajnimin e stafit:

Përgjatë periudhës Mars – Dhjetor 2023 në shërbimin e psikiatrisë në kuadër të “Edukimit në Vazhdim” janë kryer mbi dhjetë tema specialistike për trajnimin e brendshëm të stafit; si Çrregullimet Depresive, Tentativat Suicidale, Abuzimi me Substancat, Axhitimi Psikomotor, Çështje ligjore dhe Etike, Çrregullimi i spektrit autik tek fëmijët, Skizofrenia, Çrregullimet e Vëmendjes dhe hiperaktiviteti, Anoreksia Nervore, Shëndeti Mendor dhe Sëmundja Mendore.

Shërbimi mjekësor mbetet në nevojë të përhershme për shkak të kushteve minimale të sigurisë sepse mjekët dhe stafi mbështetës janë gjithmonë të rrezikuar. Pavarësisht marrjes së masave për trajnimin e task force të posaçme për përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik konform standardeve të parashikuara në nenin 27, të ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, të ndryshuar, si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute, mjekët në disa raste vazhdojnë të ndihen të pambrojtur dhe në kërcënim për jetën e tyre.

Gjatë inspektimit u konstatua se furnizimi me barna është përmirësuar dhe kur ka mungesë të medikamenteve specifike për këtë shërbim, kjo mungesë i detyron mjekët të përshkruajnë dhe të marrin masa për medikamentet alternative të së njëjtës familje.

Shërbimi social: Në kartelat e pacientëve, përveç trajtimeve medikamentose janë të përcaktuara dhe planet individuale për shërbimet Psiko-sociale, por mungesa e ambienteve rehabilituese, kushteve fizike jo të përshtatshme dhe mungesa e materialeve e vështirësojnë punën individuale për çdo pacient, pavarësisht kërkesave dhe rekomandimeve. Në spital ekziston vetëm një dhomë rekreacioni në katin e tretë, ku mungon baza materiale për aktivitete rekreative dhe lojëra tavoline (lapsa, letra, bojëra, domino, tavllë). Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013-2022, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vazhdon të ngelet i pazbatuar në këtë drejtim duke mos arritur të krijoj një rrjet të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor për trajtim, rehabilitim dhe riintegrim social. Bazuar në Rekomandimet e CPT-së, duhet që të arrihet ngritja dhe forcimi i shërbimeve komunitare të shëndetit mendor dhe në këtë mënyrë të realizohet reduktimi i numrit të shtretërve psikiatrikë. Stafi mjekësor referon që të gjitha rastet kanë gjetur zgjidhje dhe janë orientuar në shërbimet sociale përkatëse nga Punonjësi Sociale të Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës. Nevoja për shtimin në numër të stafit punonjës social vazhdon të jetë domosdoshmëri, pasi rastet dhe problematikat socio-ekonomike të pacientëve janë në rritje.

Ofrimi i shërbimit Psiko-social për personat me probleme të shëndetit mendor nuk lidhet vetëm me cilësinë e shërbimit psikologjik dhe shërbimit social të ofruar, por dhe me trajtimin sa më human dhe jo denigrues, duke mbrojtur të drejtat dhe liritë e këtyre

pacientëve të cilat janë të parashikuara në Ligjin për Shëndetin Mendor, si dhe rekomandimet e KPT-së, të shprehura dhe në Raportin e Avokatit të Popullit drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, Qershor 2022 mbi “Zbatimin e Rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti i Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues”.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme si një nevojë imediate për rikonstrukcionin e Shërbimit të Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza” Tiranë, që lidhet me rekomandimet ndër vite të Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe standardet e kërkuara dhe parashtruara nga CPT-ja dhe KE, për një trajtim sa me cilësor dhe human të personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor.
2. Marrjen e masave për vënien në funksion të plotë të sistemit qendror të ngrohjes.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e regjistrave të sekretuar nga ana e drejtorisë juridike pranë QSUT-së, si dhe marrjen e masave administrative për punonjësit që nuk kanë siguruar, pavarësisht rekomandimit, sekretimin e regjistrave.
4. Marrjen e masave urgjente për krijimin e një pavijoni të posaçëm për persona abuzues me substanca narkotike, të cilët manifestojnë çrregullime të sjelljes apo/dhe psikotike të cilët janë në rritje në numër dhe për shkak të karakteristikave të tyre kërkojnë një trajtim me të orientuar bio-psiko-social. Hera herës ky target grup pacientësh ka sjelle problematika në menaxhim, çka sjell si nevojë dhe trajnim stafi për këtë target grup.
5. Marrjen e masave për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive psiko-sociale nëpërmjet investimit për të krijuar ambiente të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese nga ana e stafit psiko-social.
6. Vënia në funksion e dhomës së izolimit duke e rindërtuar dhe pajisur në përputhje me standardet.
7. Marrjen e masave në vazhdimësi për rritjen e bashkëpunimit me Institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe analizimin me përgjegjësi të rekomandimeve në vijim.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI